

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6988
E martë, 5 shtator 2023
Çmimi 0.40 €

Shpresë për kthesë në Bruksel? Takim i ri Kurti - Vuçiq



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA FILLUAR TË HËNËN VIZITËN
DYDITORE SHTETËRORE NË SHQIPËRI

KOSOVA DHE SHQIPËRIA ZOTOHEN PËR BASHKËPUNIM NË POLITIKËN E JASHTME



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është pritë me ceremoni zyrtare në Tiranë nga homologu Bajram Begaj. Pas ceremonisë në ambientet e Presidencës, Osmani së bashku me Begajn kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për

medie. Osmani ka shtuar nevojën e rritjes së bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe paraprak në politikën e jashtme në raport me interesat e të dy shteteve, por edhe të rajonit dhe më gjerë. "Kosova dhe Shqipëria kanë një lidhje unike historike, kulturore

dhe kombëtare, lidhje kjo e fortë dhe e pathyeshme. Përballë sfidave, ne duhet të qëndrojmë të bashkuar, duke u fokusuar në qëllimin tonë madhor: integrimin e shteteve tona në familjen euroatlantike", ka theksuar Osmani

OPINION

TAKIM MIDIS "MIQVE" NË BRUKSEL MË 14 SHTATOR, THOTË JOSEP BORDELLI!

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



SCHOLZI RRËZOHET DUKE VRAPUAR

PËR TETË MUAJ KEDS-i REALIZOI MË SHUMË SE 55 MIJË KONTROLLE PËR KEQPËRDORIME TË ENERGJISË ELEKTRIKE

EKONOMI



BORXHI PUBLIK SHËNON RITJE

KUSHTETUESJA PEZULLON VENDIMIN PËR FALJEN E 100 EUROVE PËR TATIMIN NË PRONË




DËSHTON DEBATI PARLAMENTAR PËR TEKSTET SHKOLLORE



BIZNESET NË KOSOVË FILLOJNË TË MARRIN PUNËTORË TË HUAJ, SHTATË VENDE PRIJNË ME KËRKESA PËR VIZA

SPORT



GLIHA: PËR KOSOVËN JEMI GATI TË VDESIM NË FUSHË

RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Reznikovi paraqet dorëheqjen e ministrit të Mbrojtjes

KIEV, 4 SHTATOR - Oleksiy Reznikov paraqiti dorëheqjen nga pozita e ministrit të Mbrojtjes të Ukrainës, duke hapur rrugë Rustem Umerovit, një ligjvënës tatar nga Krimea, që të marrë këtë pozitë. Ky vendim i Reznikovit vjen pas njoftimit që presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, bëri më 3 shtator për ndryshimin e drejtimit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Zelensky shkroi në Telegram se udhëheqja e re në Ministrinë e Mbrojtjes ishte e nevojshme pasi Reznikovi kishte kaluar nëpër “më shumë se 550 ditë të një lufte të shkallës së gjerë”.

Ndërkaq, më vonë përmes një adresimi, Zelensky tha se beson se “Ministria ka nevojë për një qasje të re dhe forma të tjera të ndërveprimit, si me ushtrinë, ashtu edhe me shoqërinë”. “Parlamenti i Ukrainës e ka një person të tillë dhe Umerov nuk ka nevojë të prezantohet. Pres që kandidatura e tij ta ketë mbështetjen e Parlamentit”, tha

Zelensky.

Umerov, 41 vjeç, është një politikan nga partia opozitare Holos. Që nga shtatori i vitit 2022 ai ka shërbyer kryetar i Fondit Shtetëror të Pronave. Ai ka qenë i përfshirë në këmbimin e të burgosurve të luftës, të të burgosurve politikë, fëmijëve dhe civilëve, si dhe në evakuimin e civilëve nga territoret e pushtuara. Umerov, po ashtu, ishte pjesë e delegacionit ukrainas në negociatat me Rusinë sa i përket marrëveshjes së drithërave të ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara.

Shkarkimi i Reznikovit vjen pas një skandali lidhur me prokurimin e xhakave ushtarake nga Ministria e Mbrojtjes. Në gusht, gazetarët ukrainas raportuan se këto materiale ishin blerë me një çmim trefish më të lartë dhe në vend të xhakave dimërore ishin blerë xhakata verore. Në dokumentet doganore për blerjen e këtyre produkteve, një



xhakatë thuhej se kishte çmimin prej 29 dollarësh, por Ministria ukrainase e Mbrojtjes kishte paguar 86 dollarë për copë. Reznikovi javën e kaluar në një konferencë për media i mohoi të gjitha akuzat.

Më 3 shtator presidenti amerikan Joe Biden u tha gazetarëve se ishte në dijeni që Zelensky do ta zëvendësonte shefin e tij të mbrojtjes. I pyetur nga gazetarët që të komentonte këtë zhvillim, Bideni tha se nuk

“do të komentoj publikisht”. Shtetet e Bashkuara dhe shtetet e tjera perëndimore e mbështetin Ukrainën e cila po përballlet me pushtimin e paprovokuar që Rusia nisi në shkurt të vitit 2022.

Tajvani goditet nga një tajfun i fuqishëm

TAIPEI, 4 SHTATOR - Më shumë se 30 000 shtëpi në Tajvan kanë mbetur pa energji elektrike pasi tajfuni Haikui goditi pjesën jugore dhe lindore të ishullit. Si pasojë e stuhisë u mbyllën shkollat dhe bizneset, ndërkaq u anuluan pothuajse të gjitha fluturimet.

Ky ishte tajfuni i parë që goditi drejtpërdrejt Tajvanin në katër vjet. Haikui goditi pjesën malore të ishullit një juglindje para se të nisej të dielën drejt jugut.

Stuhia la pa energji elektrike mbi 240 000 amvisëri, por autoritetet thanë të hënën se mbi 34 000 shtëpi vazhdojnë të mos kenë rrymë, shumica e të cilave gjenden në qarkun lindor të Taitungut.

Shkollat u mbyllën në jug, lindje dhe në Tajvanin qendror, teksa kryeqyteti, Taipei, u godit nga



reshje shiu dhe erëra.

Autoritetet raportuan se pesë persona janë lënduar nga tajfuni,

ndërkaq ende nuk është konfirmuar nëse një person i vdekur, që u gjet buzë një rruge

në Taitung, vdiq si pasojë e stuhisë.

Tajvani, po ashtu, anuloi 208

fluturime brenda vendit dhe autoritetet lejuan vetëm disa fluturime të zhvilloheshin. Ndërkaq, 23 fluturime ndërkombëtare u anuluan, tha Administrata e Aeronautikës Civile.

Haikui është më i dobët se tajfuni Saola, që goditi Hong Kongun dhe jugun e Kinës të shtunën.

Më 4 shtator Haikui ka lëvizur në Ngushicën e Tajvanit dhe është nisur drejt Kinës, thanë autoritetet tajvaneze. Stuhia ende do të vazhdojë të sjellë të reshura të dendura shiu në ishull deri në mesin e javës.

Agjencia Kombëtare e Motit në Kinë ka paralajmëruar për erëra të fuqishme dhe valë të mëdha deti në provincat bregdetare të Fujianit dhe Guangdongit dhe u ka bërë thirrje anijeve të marrin masa mbrojtëse.

Scholzi rrëzohet duke vrapuar

BLERIN, 4 SHTATOR - U rrëzua duke vrapuar, por kancelari gjerman, Olaf Scholz, e ka marrë me sportivitet incidentin. Kreu i ekzekutivit gjerman publikoi një foto të veten ku shihej me njërin sy të mbuluar nga copë e zezë në stil pirati dhe disa mavijosje të errëta në anën e djathtë të fytyrës, që ishin rezultat i rrëzimit. “Mezi po pres të shoh memet”, ka shkruar Scholz duke u paraprirë kështu talljeve që bëhen të famshme në internet. Si për ta shmangur çdo shqetësim të mundshëm për shëndetin e tij,

në foto Scholz buzëqeshi lehtë dhe shkroi në rrjetin social X: “Faleminderit për urimet! Duket më keq sesa është!”.

Rrëzimi gjatë fundjavës e detyroi kancelarin t’i anulonte disa takime të planifikuara këto ditë. Kjo nuk e pengoi t’i rikthehej debatit mbi energjinë bërthamore përmes një interviste dhënë për “Deutschlandfunk”.

Scholz ripohoi skepticizmin për vendosjen e çmimit të subvencionuar për industrinë të energjisë bërthamore, të cilën e quajti “një kalë të ngordhur”. Me

përfundimin e shfrytëzimit ka filluar edhe çmontimi i termocentraleve bërthamore që ekzistojnë ende, tha ai duke shtuar: Po do të donim ende të ndërtonim termocentrale të reja bërthamore, do të duheshin 15 vjet dhe do të shpenzonim 15 deri në 20 miliardë euro për central.

Kohën e fundit FDP dhe CDU kanë bërë thirrje për kthim në energjinë bërthamore. AfD është, gjithashtu, në favor të vazhimit të shfrytëzimit të energjisë bërthamore.



Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Dështon debati parlamentar për tekstet shkollore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Debati parlamentar për çështjen e furnizimit me tekste shkollore të nxënësve të shkollave fillore ka dështuar të mbahet pasi deputetët e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, nuk morën pjesë.

Seanca e jashtëzakonshme e 4 shtatorit u thirr nga partitë opozitare.

Viti i ri shkollor në Kosovë nisi më 1 shtator. Por, për dallim nga 15 vjetët e fundit, furnizimi me tekste shkollore kësaj radhe nuk sigurohet nga shteti. Me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), përgjegjësia për blerjen e teksteve shkollore u takon prindërve, të cilët do të rimbursohen përmes platformës qeveritare, E-Kosova.

Pavarësisht se debati dështoi të mbahej, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ua dha fjalën përfaqësuesve të partive, të pranishme në Kuvend.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, tha se me subvencionim të teksteve shkollore, MASHTI ka bërë shkelje ligjore. Sipas tij, qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti i ka lënë nxënësit pa tekste mësimore, përdërisa deputetët e partisë në pushtet po i ikin ballafaqimit në Kuvend. "A mund të na tregojë ministria [e Arsimit, Arbërie Nagavci] se a ka

interesa personale, financiare apo të tjera që prej 4.8 milionë eurosh, koston e ka bërë 12.5 milionë euro për t'ua dhënë atyre që i kritikonte, kinse shtëpive botuese?", ka thënë Krasniqi.

Ndërkaq, ish-ministria e Arsimit, aktualisht deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, pyeti se "prej kujt po ik qeveria".

Ministria e Arsimit, sipas saj, ka dështuar të bëjë "pazar" me shtëpitë botuese për furnizim me tekste shkollore prandaj, sipas Bajramit, është krijuar kjo situatë. Ajo tha se viti shkollor mund të përfundojë dhe disa nxënës mund të mos i kenë të gjitha tekstet shkollore.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, e akuzoi ekzekutivin për mungesë guximi "për t'u ballafaquar me të vërtetën" pasi, sipas tij, tekstet nuk janë në shkollë, por në librari.

Ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, më 24 gusht ka thënë se institucioni që ajo drejton ka dështuar të arrijë marrëveshje me shtëpitë botuese, për faktin se, sipas saj, shtëpitë botuese kanë ofertuar çmime shumë më të larta se ato që i vendosin në libraritë e tyre.

Por, një gjë e tillë është mohuar nga përfaqësuesit e disa botuesve.

MASHTI ka ndarë nga 80 euro për nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën dhe nga 30

euro për ata nga e gjashta deri në të nëntën, pasi i kanë siguruar librat nga viti i kaluar.

Për subvencionim të teksteve dhe materialeve tjera të nevojshme, Qeveria e Kosovës javën e kaluar ka ndarë rreth 13 milionë euro.

Numri i nxënësve nga klasa e parë deri në të nëntën në Kosovë llogaritet të jetë 213 000.

KMDLNj: Rrëmuja për libra, a ishte e nevojshme dhe e arsyeshme?!

Para fillimit të vitit shkollor dështoi marrëveshja midis MASHTI-t dhe botuesve të librave shkollore dhe, si rezultat i saj, në vend se librat të shpërndahen si më parë, u gjet një tjetër rrugë që përmes aplikimit për rimbursim të kompensohen prindërit që i blejnë tekstet shkollore për fëmijët e tyre.

E tëra kjo shkaktoi një rrëmuje në libraritë apo pikat shitëse ku të njëjtët botues që nuk arritën marrëveshje me MASHTI-n tash i shesin librat shkollore. "U krijuan radhë të gjata, viti shkollor filloi me vonesa ku nxënësit që nuk ishin pajisur me tekste të reja, ose shkuan me tekste të vjetra ose fare pa to. Tash, përgjegjësia për këtë rrëmuje të shkaktuar dhe komplikim të gjendjes endej si topi i ping - pongut, nga njëra fushë (MASHTI) te tjetra (botuesit) ndërsa prindërit dhe nxënësit e pësuan shkak i

papërgjegjësive institucionale, në radhë të parë e pastaj nga përgjegjësia nuk mund të lirohen krejtësisht as botuesit. Qeveritë e mëparshme e kishin krijuar një standard të furnizimit me libra shkollore falas dhe kjo mirë funksiononte, prandaj për KMDLNj-në mbetet i paqartë shkaku pse MASHTI veprimi në këtë mënyrë. Nëse MASHTI përmes kësaj forme të kompensimit ka arritur të kursejë mjete nga buxheti i Kosovës, pra nëse kostoja del të jetë më e lirë se nga ato të mëhershmet, atëherë edhe mund të arsyetohet dhe të mos i nënshtrohet përgjegjësive", është thënë në reagimin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Mirëpo, sipas KMDLNj-së, në anën tjetër, mënyra për të cilën është përcaktuar MASHTI për furnizim me libra shkollore falas del të jetë më e kushtueshme se ajo e qeverive paraprake. "Atëherë duhet të bëhet një hetim pas së cilës do të përcaktohej përgjegjësia në të gjitha nivelet varësisht nga shkalla e përgjegjësive. MASHTI gjithashtu duhet që përmes drejtorive komunale të arsimit të identifikojë dhe të kompensojë edhe ata prindër të cilët në pamundësi për të aplikuar online kanë blerë librat ose ende nuk e kanë bërë. Furnizimi me libra shkollore po ecën me një ritëm të ngadalësuar dhe KMDLNj pyet nëse kjo ka qenë e nevojshme, e arsyeshme dhe mënyra më e

duhur dhe më e përshtatshme. As prindërit e as nxënësit nuk duhet të paguajnë çmimin e papërgjegjësive institucionale apo të dëshirës së botuesve për të fituar më shumë sepse as që janë pyetur për këtë", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj kërkon që rasti të sqarohet deri në fund dhe të mos mbetet vetëm si përplasje midis pozitës dhe opozitës ku pozita arsyeton çdo vendim dhe çdo veprim, ndërsa opozita e sulmon çdo vendim dhe çdo veprim. "Kosova po përballet me shumë probleme të natyrës politike dhe ekonomike, si pasojë e politikës, prandaj duhet të arrihet një konsensus kombëtar, politik dhe shtetërorë midis pozitës dhe opozitës që të kalohet me sa më pak pasoja në këtë përbalje. Debati parlamentar për librat shkollore në një seancë të jashtëzakonshme të thirrur nga opozita, sipas KMDLNj-së nuk është prioriteti numër një sot në Kosovë dhe ky debat nuk do të prodhojë asnjë rezultat praktik përveç se që përmes fjalorit të tensionuar do të ndikojë që çarjet pozitë - opozitë të thellohen edhe më shumë duke marginalizuar problemet kryesore me të cilat sot po përballet Kosova të natyrës politike dhe ekonomike në kohën kur po rritet presioni ndaj Kosovës përmes kushtëzimeve të cilat seriozisht e rrezikojnë të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.



PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA FILLUAR TË HËNËN VIZITËN DYDITORE SHTETËRORE NË SHQIPËRI

Kosova dhe Shqipëria zotohen për bashkëpunim në politikën e jashtme

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është pritur me ceremoni zyrtare në Tiranë nga homologu Bajram Begaj. Pas ceremonisë në ambientet e Presidencës, Osmani së bashku me Begajn kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për medie. Osmani ka shtuar nevojën e rritjes së bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe paraprak në politikën e jashtme në raport me interesat e të dy shteteve, por edhe të rajonit dhe më gjerë. “Kosova dhe Shqipëria kanë një lidhje unike historike, kulturore dhe kombëtare, lidhje kjo e fortë dhe e pathyeshme. Përballë sfidave, ne duhet të qëndrojmë të bashkuar, duke u fokusuar në qëllimin tonë madhor: integrimin e shteteve tona në familjen euroatlantike”, ka theksuar Osmani

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

TIRANË, 4 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka filluar të hënën vizitën dyditore shtetërore në Shqipëri, me ç'rast është pritur me nderimet më të larta shtetërore nga presidenti Bajram Begaj. Në takim me presidentin Begaj, presidentja Osmani e ka falënderuar Shqipërinë për mbështetjen dhënë Kosovës në të gjitha etapat e përpjekjeve për liri, pavarësi dhe shtetndërtim. Osmani ka shtuar nevojën e rritjes

së bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe paraprak në politikën e jashtme në raport me interesat e të dy shteteve, por edhe të rajonit dhe më gjerë. “Kosova dhe Shqipëria kanë një lidhje unike historike, kulturore dhe kombëtare, lidhje kjo e fortë dhe e pathyeshme. Përballë sfidave, ne duhet të qëndrojmë të bashkuar, duke u fokusuar në qëllimin tonë madhor: integrimin e shteteve tona në familjen euroatlantike”, ka theksuar Osmani.

Sipas presidentes Osmani, Kosova është e përkushtuar ta fuqizojë

pozicionin e saj ndërkombëtar, duke shtyrë më tej synimin për njohje të reja dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Osmani ka shtuar nevojën e vazhdimin të mbështetjes nga ana e Shqipërisë. “Kjo sfidë kërkon përkushtim dhe veprime të sinkronizuara për njohje të reja dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Si në të kaluarën, presim që Shqipëria të jetë zëri ynë në vendet dhe forumet ku ende nuk jemi pjesë”, ka theksuar Osmani. Më tej, presidentja përmendi

anëtarësimin në Këshillin e Evropës, NATO, BE, por edhe organizata të tjera ndërkombëtare. “Anëtarësimi i Kosovës në NATO si synim afatgjatë dhe përfshirja sa më parë në Programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s janë garanci për paqe dhe siguri në rajon dhe kontinentin tonë. Fakti që Shqipëria tashmë është anëtare e NATO-s krijon siguri më të madhe në gjithë rajonin tonë, në veçanti në Kosovë”, ka theksuar presidentja Osmani.

Në raport me zhvillimet politike dhe të sigurisë në vend, presidentja Osmani theksoi se Kosova, përkundër sfidimit të hapur në rrafshin e sigurisë dhe institucional nga Serbia, vazhdon të jetë e përkushtuar ndaj procesit të dialogut, si dy shtete të pavarura dhe fqinje. Sipas Osmani, rezultati përfundimtar i tij duhet të jetë njohja reciproke dhe ruajtja e integritetit territorial, sovranitetit, rendit kushtetues dhe funksionalitetit institucional të Republikës së Kosovës. Osmani ka thënë se stabiliteti i plotë në rajon do të ndodhë kur Serbia ta njohë sovranitetin dhe

integritetin territorial në Kosovës. “Koordinimi me miqtë dhe aleatët tanë është parakusht. Dialogu vijon, stabiliteti i plotë është atëherë kur të njihet sovraniteti i Republikës të Kosovës”, është shprehur ajo, duke shtuar se Serbia acaron gjithnjë situatën në rajon. “Nuk është situata në veri ajo që ka acaruar dialogun Kosovë - Serbi. Është Serbia ajo që gjithnjë acaron situatën në rajonin tonë nëpërmjet sulmeve të njëpasnjëshme ndaj Kosovës. Nuk ka javë që kalon që dikush nga Serbia nuk gjuan me armë policët e Kosovës që janë në territorin e Kosovës. Duke zbatuar në përpikëri planin që Putini kishte zbatuar në vitin në vitin 2014 kundër Ukrainës, Vuçiqi dhe Serbia po synojnë ta destabilizojnë të gjithë Ballkanin Perëndimor, e nëpërmjet destabilizimit të rajonit tonë t'i atakojnë vlerat dhe sistemin e vlerave mbi të cilët qëndrojnë BE-ja dhe NATO-ja”, ka thënë Osmani.


Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, porositi që Kosova dhe Serbia të punojnë për zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve që u arrit në shkurt pasi,

PDK-ja dhe LDK-ja paralajmërojnë kallëzim penal ndaj ministres Nagavci

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Dy partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kanë paralajmëruar kallëzim penal ndaj ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, për çështjen e teksteve shkollore. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se Nagavci është përgjegjëse për privimin e 210 mijë nxënësve dhe mosrealizimin e kompetencave ligjore për tekstet shkollore. “Në

buxhetin e këtij viti këta e kanë edhe të buxhetuar. Ne do t'i bëjmë kallëzim penal ministres së Arsimit sepse është përgjegjëse direkte për privimin e 210 mijë nxënësve, duke mos realizuar një kompetencë të saj ligjore. Ne do t'i bëjmë një kallëzim penal ministres në këtë rast. Dhe u bëjmë thirrje të gjithë prindërve të ushtrojnë kallëzim penal në bazat e tyre private për privimin e fëmijëve të tyre për tekstet shkollore”, ka thënë Tahiri në një konferencë për medie.

Edhe shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka paralajmëruar kallëzim penal ndaj ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, lidhur me vendimin për subvencionim të teksteve shkollore. Gashi këtë vendim e ka quajtur antiligjor, duke e quajtur qeverinë Kurti të paaftë për ta menaxhuar situatën me tekstet shkollore. “Qeveria është në shkelje të Ligjit për Tekste Shkollore dhe në shkelje të Ligjit Parauniversitar. Kjo është një shkelje shumë e rëndë që



ministra po bën dhe për këtë do të përballet, sipas të gjitha gjasave, edhe me ndjekje penale ministria e Arsimit”, ka

thënë Gashi në një prononcim për medie pas dështimit të seancës së jashtëzakonshme për çështjen e teksteve shkollore. Në këtë kontekst, Gashi ka thënë se ky “keqmenaxhim” u ka shkakuar prindërve dëme ekonomike dhe emocionale. “Mendoj që paaftësia e qeverisë për ta menaxhuar këtë proces ka shkakuar një dëm të madh ekonomik dhe dëm emocional për prindërit dhe nxënësit i cili është dëm i pariparueshëm”, ka thënë Gashi.

Shpresë për kthesë në Bruksel? Takim i ri Kurti - Vuçiq

Konfirmimi për takimin e ri në mes të Kurtit dhe Vuçiqit erdhi pas bisedimeve intensive që i dërguari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, zhvilloi gjatë javës së shkuar me kryeministrin Kurti dhe presidentin Vuçiq

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Pas një periudhe tensionesh në veri dhe përplasjes në distancë me një retorikë të ashpër, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen më 14 shtator në Bruksel nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Takimin e ka konfirmuar kreu i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, dhe i dërguari i tij për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak.

Javën e kaluar Lajçaku takoi ndaras dy udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë dhe tha se “dy liderëve ua ka rikujtuar se të gjitha marrëveshjet e dialogut janë valide dhe se ato duhen zbatuar plotësisht dhe pa vonesa”. “Në Bled unë kisha takim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Ne biseduam për përgatitjet për takimin e radhës të nivelit të lartë në shtator, me përqendrim të



normalizimi i marrëdhënieve dhe zbatimi i deklaratës së BE-së të 3 qershorit. Po ashtu, kam ngritur shqetësimin rreth situatës në veri të Kosovës”, pati shkruar Lajçak në “Facebook”.

Nga Bledi, Lajçak udhëtoi për në Beograd, ku takoi presidentin e

Serbisë, Aleksandër Vuçiq. “Kemi biseduar në detaje për përpjekjet për ulje të tensioneve dhe mbajtje të zgjedhjeve të reja në veri të Kosovës, si dhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të dialogut. Ua kam kujtuar të dy liderëve se të gjitha marrëveshjet e dialogut

mbesin valide dhe detyruese për të dyja palët dhe duhen zbatuar plotësisht dhe pa kushte apo vonesa”, ka shkruar Lajçaku pas takimit me Vuçiqin.

BE-ja kërkon hapa të tjerë nga Kosova për shtensionimin e situatës

Kryeministri Kurti dhe presidenti Vuçiq për herë të fundit janë takuar katër muaj më parë, më 2 maj, vetëm pak kohë pas mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme në veri të Kosovës, zgjedhje këto të cilat janë bojkotuar nga serbët lokalë. Në muajin qershor, Bashkimi Evropian kërkoi uljen e tensioneve me kërkesë të qartë: pezullimin e operacioneve policore në veri, zhvendosjen e kryetarëve të komunave në zyra alternative dhe shpalljen e

zgjedhjeve të parakohshme me pjesëmarrje të pakushtëzuar të serbëve të Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka njoftuar se tashmë ka përgjysmuar praninë e njësisve të policisë në ndërtesat komunale në veri dhe është pajtuar për organizimin e zgjedhjeve të reja. Në këtë rrethanë të re qeveria kërkon që Bashkimi Evropian t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës të cilat u vendosën, sipas BE-së, në “mungesë të koordinimit dhe sjellje joevropiane lidhur me zhvillimet në veri. Bashkimi Evropian ka thënë se veprimet e fundit të qeverisë në drejtim të shtensionimit të situatës në veri janë hapa të rëndësishëm në drejtimin e duhur, por nevojiten hapa të tjerë për ta zbutur krizën në veri me zgjedhjet e parakohshme që duhet të mbahen sa më shpejt”.

Osmani takon edhe Ramën

Presidentja Osmani ka takuar edhe kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, me të cilin ka njoftuar se ka pasur një bisedë përmbajtësore rreth aspiratës së përbashkët evropiane të

Kosovës dhe Shqipërisë. “Duke punuar së bashku, Kosova dhe Shqipëria mund ta hapin rrugën për një të ardhme më të ndritshme dhe më të integruar”, ka thënë Osmani pas takimit.

sipas tij, kjo marrëveshje eventualisht do të çojë në njohje reciproke. Megjithatë, në marrëveshjen prej 11 nenesh nuk përfshihet njohja reciproke për të cilën insiston Kosova, por kërkon nga Kosova dhe Serbia t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat.

Begaj, po ashtu, kërkoi nga Kosova të ketë bashkëpunim më të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë. “Pavarësisht prej provokimeve për ta tensionuar situatën në veri të Kosovës dhe ndërhyrjeve hibride nga aktorët të

tretë dashakeqës, duhet një koordinim më i mirë dhe më i ngushtë me partnerët tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, për të gjitha veprimet e ndërmarrja”, ka thënë Begaj gjatë konferencës së përbashkët për medie.

Kreu i shtetit shqiptar përsëriti disa herë se Kosova është prioritet kombëtar dhe se të gjitha strukturat institucionale të Shqipërisë po punojnë që Kosova ta rrisë numrin e njohjeve ndërkombëtare, por edhe të anëtarësohet në mekanizma rajonale dhe ndërkombëtarë.



"Nagip Rexhepi" në Gjilan pajiset me aparaturë të re për pacientët me diabet

GJILAN, 4 SHTATOR – "Për herë të parë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjilan ofron shërbime për pacientët me diabet përmes aparatit për testim të hemoglobinës së glukozuar, e cila mundëson diagnostikimin e sëmundjes

së diabetit si dhe tregon nivelin mesatar të sheqerit në gjak gjatë tre muajve të fundit", ka bërë me dije kryetari i komunës, Alban Hyseni. Ai ka thënë se përpos kësaj, QKMF-ja është pajisur edhe me çanta me pajisje të

reja mjekësore si: tensiometër, otoskop, oftalmoskop, termometër, glukometër e dhjetëra pajisje të reja. "Vazhdojmë ndryshimet në sistemin shëndetësor", është shprehur kryetari i Gjilanit.



Për tetë muaj KEDS-i realizoi më shumë se 55 mijë kontrole për keqpërdorime të energjisë elektrike



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Keqpërdorimi ose vjedhja e energjisë elektrike vazhdon të mbetet një fenomen i shëmtuar në shoqërinë tonë. Edhe pse falë investimeve qindramilionëshe në rrjet dhe luftës së pakompromis të KEDS-it për luftimin e keqpërdorimit të energjisë elektrike, kjo dukuri vazhdon të jetë shqetësuese. Vetëm përgjatë periudhës janar-gusht 2023 KEDS-i ka realizuar më shumë se 55 000 kontrole për t'i evidentuar keqpërdorimet/vjedhjet e energjisë elektrike, prej të cilave afër 4 500 raste janë identifikuar si keqpërdorime. KEDS-i ka shtuar praninë e ekipeve të kontrollit në terren

me qëllim të minimizimit të humbjeve në rrjet, duke realizuar kontrole çdo ditë në tërë territorin e Kosovës. Këto kontrole të domosdoshme për identifikimin e keqpërdoruesve të energjisë elektrike janë dëshmi se keqpërdorimet e tilla janë të papranueshme dhe të dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në periudhën janar-gusht 2023, Zyra Ligjore e KEDS-it ka dorëzuar afër 1 500 kallëzime penale në gjykatat kompetente të Kosovës. KEDS-i ka njoftuar se mbetet i përkushtuar ta vazhdojë luftën ndaj keqpërdoruesve të energjisë elektrike dhe i siguron ata se ka mjete të sofistikuar për identifikimin e tyre.

Përurohët objekti i shkollës "Asim Vokshi" në Panorc të Malishevës

MALISHEVË, 4 SHTATOR - Të hënën është përuar objekti i ri i Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Asim Vokshi" në Panorc. Në ceremoninë e përuimit, morën pjesë edhe kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, drejtoresha e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Arbëreshë Krasniqi, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë të drejtorisë për arsim, banorë të fshatrave Panorc e Rud, të cilët, bashkë me nxënësit dhe mësimdhënësit, e bënë përuimin e objektit të ri të kësaj shkolle. Pasi i ka uruar, nxënësit, mësimdhënësit dhe banorët, i pari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, tha se si qeveri komunale janë duke bërë përpjekje për rritje të cilësisë në

shkolla. "Jemi duke investuar në infrastrukturën shkollore, në hapësirën e nevojshme dhe krijimin e kushteve sa më të mira, me qëllimin e vetëm: rritjen e cilësisë dhe arritjes së sukseseve në arsim", ka thënë Kastrati. Ndërsa drejtoresha e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Arbëreshë Krasniqi, në fjalën e rastit i ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar për ndërtimin e këtij objekti modern shkolle. Edhe drejtori i shkollës, Bali Rudi, i ka falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë, për ndërtimin e objektit të shkollës, në veçanti komunën e Malishevës dhe Drejtorinë për Arsim dhe Edukim, më pas folur edhe për historikun e shkollës që nga viti 1947 e deri më sot.



MIJD 2023, një edicion i jashtëzakonshëm për Mitrovicën



MITROVICË, 4 SHTATOR - Nata e mbylljes së festivalit Mitrovica International Jazz Days ka sjell një energji të mrekullueshme në qytetin e Mitrovicës. Ky festival i suksesshëm është bërë një ngjarje e rrallë për komunitetin muzikor dhe adhuruesit e muzikës në këtë qytet. Në natën e mbylljes shumë qytetarë ishin të pranishëm duke shijuar muzikën e jazzit në ambientet magjike të Mitrovicës.

Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, është shprehur e lumtur dhe krenare për mbështetjen që komuna e Mitrovicës ka ofruar për këtë festival të madh të jazzit, i cili u drejtua me pasion nga Rona Nishliu. "Në natën e fundit të festivalit, shijuar performancat e disa grupeve dhe artistëve të shquar jazz si Bill Laurance & Michael League, Daphna Levy dhe Tamir Miler, dhe Up Youth Ensemble nën udhëheqjen e

Dukagjin Muhaxherit. Përveç performancave të mrekullueshme, MIJD ofroi edhe punëtori dhe aktivitete të ndryshme për muzikantët e rinj edhe për fëmijët. MIJD do të mbetet një ngjarje e rëndësishme dhe emocionuese për Mitrovicën dhe të gjithë dashamirësit e muzikës jazz. Ky ishte edicioni i parë i mrekullueshëm i MIJD. Mirupafshim në edicionin e radhës!", është shprehur drejtoresha Idrizi.

Takim midis “miqve” në Bruksel më 14 shtator, thotë Josep Bordelli!



Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA

Mocioni si përpjekje për reanimacion: Opozita nuk është aspak e kënaqur me pozitën, me qeverinë Kurti 2 e sidomos me Albin Kurtin si kryeministër. Deri më tani opozita nuk e ka penguar me asgjë qeverinë madje, në jo pak raste i ka votuar ligjet të cilat Kurti asnjëherë nuk do i votonte, po të ishte në opozitë. Ramush Haradinaj, frontman i AAK-së që nga fillimi kishte deklaruar se Albin Kurti është mashtrues mirëpo gjithmonë ishte i gatshëm të bashkëpunonte me Kurtin. Ndaj Kurtit shprehte dyshime se po punon sipas agjendës së Serbisë dhe kishte kërkuar hetime për të kaluarën e tij. Për Besnik Bislimin, pa asnjë dyshim tha se është bashkëpunëtor i Serbisë sikur edhe për disa ministra tjerë. Po del se qeveria Kurti 2 është qeveri nën hije e Serbisë gjë që është problem për të besuar. Albin Kurti e zgjodhi mënyrën më të keqe dhe më poshtëruese për “bashkëpunim” me opozitën duke e shpërfillur skajshëm dhe trajtuar si opozitë kriminale dhe armiqësore përjashtuar rastet kur kishte nevojë për votat e saj. Fuqia e madhe politike përmes mbi 50% të votave e zhvendosi Kurtin dhe ministrat injorantë, arrogantë, një pjesë edhe paedukatë në një realitet tjetër duke i dhënë të drejtë të sillen si të duan. Ka qenë e pritshme që, herët a vonë do të ketë “kryengritje” të opozitës e që fillimisht u manifestua me kërkesën e AAK-së për përkrahje të mocionit për rrëzim të qeverisë Kurti 2 por që nuk u përkrahë nga PDK-ja dhe LDK-ja që këmbëngulin që vendi të shkojë në zgjedhje shkaku se janë të sigurt se, tani për tani nuk mund t’i sigurojnë votat e mjaftueshme gjë që është e saktë. Votat e Listës Serbe nuk i duan për rrëzim të qeverisë Kurti 2 ndonëse i pranojnë kur kanë nevojë për formim të institucioneve. Kjo është dyfytërsi politike dhe morale. Qeveria Kurti 2 mund të rrëzohet vetëm me protesta

të përditshme, nëse sigurohet një masë kritike e protestuesve. Po a ka interes opozita ta rrëzojë qeverinë Kurti 2 në këto rrethana?! Besoj se nuk ka asnjë interes ta rrëzojë qeverinë por kanë interes të bëhen pjesë e qeverisë në të cilën përsëri do të qeveriste vetëm Kurti. AAK-ja në një kohë nuk e kundërshtonte këtë, LDK-ja ishte në pritje të heshtur ndërsa për PDK-në jam i sigurt se nuk do të pranonte të bëhej pjesë e qeverisë Kurti 2, në asnjë rrethanë. LDK-ja rri cuc para Lumirit, njeriut që pa asnjë pikë djerse dhe mundimi e mori partinë duke mos e merituar këtë post me asgjë. Po ky Lumiri i rri cuc Vojsa Osmanit e cila u bë presidente ekskluzivisht sipas dëshirës së Albin Kurtit i cili edhe sot e mbanë peng. Natyrisht se Vojsa Osmani e ka zgjedhur statusin e të mbajturit peng krejt vullnetarisht, për një post të cilin nuk e ushtron efektivisht, postin e Presidentes. Tërë kohën e ka luajtur rolin e këshilltares për çështje ushtarake të Zelenskit, bashkë me atë këshilltarin e fejsbukut që rri kujdestar se çka po ndodhë në Serbi dhe a i kanë ardhur menstruacionet Vulinit për t’u kapur pastaj me te. Një armik që e patën, Prigozhinin nuk e kanë më, tash u ka mbetur edhe Putini. Çfarë injorantësh, punën llugë në shtëpi e po i rregullojnë punët, jo në koshin për në Ukrainë, Rusi dhe Bjellorusi! Çfarë injorantësh! Edhe tash AAK-ja nuk po kërkon zgjedhje por rrëzim të qeverisë Kurti 2 dhe formimin e një qeverie teknike, deri në një zgjidhje tjetër. E ajo zgjidhje nuk vjen se nuk vjen por, e them hipotetikusht, edhe nëse vjen në krye do ta keni projugosllavin dhe proserbin e thekur, Jeton Qurroin. Opozita e tashme nuk bashkëpunon as në pikat që duhet të jenë të përbashkëta për opozitën e lëre më për rrëzimin e qeverisë aktuale. Prandaj, më mirë është të angazhohen për thellim të reformave, përpjekje për rikthim të elektoratit të humbur dhe punën me diasporën. Një parti normale që mendon të jetojë dhe veprojë edhe një kohë në Kosovë, në rrethana aktuale, edhe nëse ia japin pushtetin në pjetë, nuk duhet ta pranojë sepse nuk është kohë e mirë dhe e përshtatshme për aktivitet normal politik dhe marrje të vendimeve të pavarura në kohën kur Kosova

është para problemeve të mëdha sidomos në marrje të vendimeve që do ta përcaktojnë të ardhmen e saj kombëtare, politike dhe shtetërore. Vendimet e mëdha merren tjetërkund, nga ju kërkohet t’i pranoni pa asnjë kundërshtim dhe t’i zbatoni, gjithashtu pa asnjë kundërshtim. Cili udhëheqës i dinjitetshëm, i përgjegjshëm e që e ka një minimum të ndershmerisë dhe korrektësisë do ta pranonte këtë?! Për fat të keq sot në Kosovë nuk ka politikanë që për shkak të interesave të përgjithshëm i mohojnë interesat personale, ndodhë pikërisht e kundërta. Deri në kohën kur pozita do të sillte sipas një korrektësie minimale me opozitën, opozita nuk do të duhej t’i votonte asnjë ligj pozitës duke e lënë të vetmuar në rrugëtimin e saj të theqafjes! Pa e penguar me asgjë!

Kurti e ka edhe përkrahjen ndërkombëtare: Opozita, në rrëzimin e qeverisë Kurti 2 ka llogaritur edhe në votat e ndërkombëtarëve sipas një automatizmi me qeverinë Kurti 1 që mori në thua në këmbën e Grenellit. Opozita ka bërë llogaritë e gabuara në këto baste politike për faktin se Albin Kurti ka mbi 50% të votave dhe kjo i lejon një komoditet të bëjë ç’të dojë brenda vendit sikur edhe ta luaj një rol të macho politikantit në skenën ndërkombëtare. Këtë mundësi Kurti e ka shfrytëzuar 100% brenda vendi duke krijuar institucione që udhëhiqen nga ish-udbashët apo pasaradhësit e tyre, ish projugosllavët dhe proserbët me të cilët ka mbjell thujat të gjitha institucionet duke i larguar apo përndjekur ish të burgosurit politikë, ish-ushtarët e UÇK-së, fëmijët e tyre apo edhe familjet e tyre. Kjo lehtësisht sot mund të shihet, pa pasur nevojë të gërvishte më thellë. Në institucione ka ish-paramilitarë serbë, ish-policë të Serbisë dhe ish oficerë apo ushtarë të ushtrisë serbe dhe jugosllave. Ka dëshmitarë që kanë dëshmuar në procese politike kundër veprimtarëve politikë shqiptarë, kundër ushtarëve shqiptarë në ish-Jugosllavi që janë dënuar ose vrarë gjatë shërbimit ushtarak. Qeveria Kurti 2 është e çliruar nga çdo patriotizëm, nga nacionalizmi shqiptar e që ndërkombëtarët e vlerësojnë shumë. Ministra por edhe disa zyrtarë të qeverisë

Kurti 2 kanë qëndrim sadist dhe hakmarrës ndaj atyre që e bënë luftën e lavdishme çlirimtare në Kosovë e që tani po mbahen si pengje të Gjykatës Raciste Speciale në Hagë. Pas një kohe, kur të hapen letrat do të vërtetohet kontributi shumë domethënës i disa ministrave dhe z/ministrave të Qeverisë Kurti 1 dhe 2, si gjatë dëshmime, sigurimit të “dëshmitarëve të mbrojtur”, mosdhënien e garancive për lirimin e tyre si dhe përpjekjeve që t’ua bëjnë jetën sa më të vështirë pengjeve të Hagës dhe familjeve të tyre. Ndërkombëtarët këto gjëra i pëlqejnë, duan që vet të jenë nacionalistë por nuk ua lejojnë të tjerëve. Për një interes shtetërorë dhe kombëtar janë në gjendje të shkatërrojnë shtete me mijëra e mijëra kilometra larg ndërsa nuk lejojnë bashkim të natyrshëm me popullin dhe shtetin nga i cili ju kanë ndarë dhunshëm. Bashkimin kombëtar, qeveria Kurti 2 do ta bënte që sot po të mos ishte Kushtetuta e mallkuar e Kosovës e cila, kur Kurti hypi në pushtet e futi një nen që e ndalon bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Këtë e duan ndërkombëtarët, nuk e duan bashkimin me Shqipërinë por nuk e kundërshtojnë, madje edhe punojnë për bashkim me Serbinë. Ka në qeverinë Kurti 2 z/ministra që kanë ikur nga lufta dhe pastaj kanë deponuar deklarata që, përkahe poshtërsia ia kalojnë edhe Nazim Bllacës. Të tillë i do Kurti, të tillë i duan ndërkombëtarët. Disa zyrtarë dhe referentë me poste ministrore të qeverisë Kurti 2 kanë të kaluar kombëtare, qoftë të fituar me meritë, qoftë të trashëguar, pa meritë. Të parët duhet të kthjellen kurse të dytët më mirë mos të flasin fare për prejardhjen e tyre. Ndryshe, si do të lejonin që logjika projugosllave dhe proserbe të aktualizohet edhe tash. Si do të rrinin cuc para ish paramilitarëve dhe ish ushtarëve të ushtrisë jugosllave dhe serbe. Si do të rrinin cuc para anastaslulove të Tiranës dhe një andarteje greke që ua ka shpërlarë trurin, dikur me idenë Megali Albania e tash me angazhimin për Megali Serbia. Po edhe nëse Albini, me të tijet vendosë që edhe lëkurën të na rrjepin, ndërkombëtarët nuk do të reagojnë sepse iu duhet për procese politike që e presin Kosovën e që e kanë ambalazhuar me normalizim të marrëdhënieve me Serbinë.

Këtë e duan ndërkombëtarët prandaj ia lejojnë një sjellje prej macho politikani edhe në planin ndërkombëtar. Sepse janë të sigurt se është dhe do të jetë i dëgjueshëm për të gjitha çështjet para tyre. Në publik le të flasë çka të dojë, fjalët i bartë era. Me rëndësi është nënshkrimi dhe Albini di mirë të nënshkruaj. Albini do t’i nënshkruaj të gjitha vetëm që të mos përjashtohet nga qendra e vëmendjes. Vetëm t’i mundësohet “shoqërimi” me Miqotakis dhe Dendias, me Laçak dhe Bordell. T’i mundësohet ta mësojë zonzjën Macron për historinë e Francës, Revolucionin Borgjez francez, Robespierin, Dantonin dhe Napoleonin, t’i ligjërojë diplomatit Solana për artin spanjoll dhe botëror në muzeun Prado në Madrid, të ligjërojë për maurët dhe saracenët apo për rëndësinë e Kanalit të Panamasë për ekonominë e Kosovës, sipas paramilitarit Murati. Të tregojë muskuj para Ramës dhe Ali Ahmetit, mes të tjerash. Është i zgjuar, ka shkathtësi oratorike, krijon kriza të vogla për ta mbuluar dështimin e madh, bartë këto kriza në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Luginë të Preshevës por jo edhe Serbi apo Mal të Zi. Në vend të politikës së jashtme ka prostitucion diplomatik, në vend të shkollimit ofron analfabetizëm funksional. Në vend të zhvillimit ka varfëri të shtuar dhe luftë për mbijetesë. Punësimi në baza familjare dhe partiake është shndërruar në kategori që mbrohet nga Kushtetuta e Kosovës. Kapja e institucioneve, të të gjitha niveleve, përkahe perversiteti ia kalon edhe Markezit de Sad. Disi kam një siguri se Albin Kurti e ka përkrahjen e madhe të ndërkombëtarëve, në të kundërtën që moti do t’ia kishin hequr puplat duke e lënë të lakuriquar. Po pse nuk ka reagim qytetar ndaj kësaj gjendjeje, me të drejtë do të pyesni. Për një jam shumë i sigurt se mosreagimi qytetar është se po presin 1 janarin e vitit 2024 kur, sipas premtimeve koha kur do të liberalizohen vizat për qytetarët e Kosovës dhe se fatin më nuk e lidhin me Kosovën por me ndonjë shtet të perëndimit. Përveç të rinjve Kosovën po e lëshojnë edhe qytetarë të moshës së mesme për t’i marrë më vonë edhe ata që me një këmbë janë në varr. Ta shohim, shpejtë vjen kjo ditë dhe kjo datë!

Kushtetuesja pezullon vendimin për faljen e 100 eurove për tatimin në pronë

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Gjykata Kushtetuese ka pezulluar vendimin për ndryshimet në Ligjin për Tatimin në Pronë, që parashihte faljen e tatimit deri në 100 euro për qytetarët. Kushtetuesja pranoi kërkesën e parashtruar nga komuna e Prizrenit, duke vendosur masë të përkohshme deri në nëntor të vitit 2023 për nenin 5 të ligjit derisa të merret një vendim përfundimtar.

Në këtë nen, veç të tjerash, parashihej që çdo tatimpagues të kualifikohej për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej 100 eurosh.

Kushtetuesja argumentoi se

vendimi u mor bazuar në kompetencat vetjake të komunave, ku përfshihen edhe e drejta për mbledhjen e të ardhurave nga tatimet dhe shpenzimin e këtyre të hyrave sipas vendimit të vetë autoriteteve lokale. “Për më tepër, vendosja e masës së përkohshme ndaj nenit 5 të ligjit të kontestuar, përkatësisht pezullimi i efekteve të tij deri në vendimmarrjen përfundimtare të gjykatës, mundëson evitimin e cenimit të përgjegjësive komunale dhe zvogëlimin të të hyrave përkatëse komunale, në rast që gjykata

vendimmarrjes përfundimtare konstaton që neni i lartcekur nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën”, u tha në njoftimin e Gjykatës Kushtetuese.

Ligji për Tatimin në Pronë ka hyrë në fuqi më 14 gusht.

Më herët gjatë këtij viti kreu i Ministrisë të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, kishte deklaruar se në bazë të ndryshimeve ligjore, 85 për qind e tatimpaguesve nuk do të paguanin asgjë për vitin 2023, 10 për qind të tjerë do të paguanin më pak se 100 euro dhe vetëm 5 për qind e tatimpaguesve do të paguanin



më shumë se 100 euro. Por, vendimi për faljen e tatimit në pronë pasoi rritjen e këtij tatimi në vitin 2023. Rritja u shkaktua

pas vlerësimit të përgjithshëm të tokave dhe objekteve të banuara që bëri Ministria e Financave vitin e kaluar.

Bizneset në Kosovë fillojnë të marrin punëtorë të huaj, shtatë vende prijnë me kërkesa për viza

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Dilemat për largim të një pjese të punëtorëve nga vendi, nga 1 janar i 2024-s, kur është paraparë të liberalizohen vizat, i kanë shtyrë bizneset që të gjejnë alternativa të tjera në mënyrë që të mos mbesin pa staf.

Shumë kompani po merren me procedurat e rekrutimit të punëtorëve nga vendet aziatike si Bangladeshi e Nepali. “Disa biznese veçse kanë filluar të kontraktojnë edhe punëtorë jashtë vendit, e sidomos pjesa e bizneseve të gastronomisë”, tha për RTK-në Hysen Sogojeva, kryetar i Odës së Hotelerisë dhe Turizmit.

Nga Ministria e Punëve të Jashtme kanë thënë se nga janari 2022 deri në qershor të këtij viti kanë aprovuar 381 viza pune, ndërsa 165 janë refuzuar. “Më së shumti kërkesa për viza pune në Kosovë janë pranuar nga Bangladeshi, India, Nepali, Egjipti, Filipinet, Pakistani dhe Bosnja”, kanë thënë nga MJD.



Megjithatë, punësimi i të huajve nuk do të jetë një zgjidhje afatgjatë për bizneset. “Duke u bazuar në

Ligjin nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Kosovës, Agjencia ka mandat të lëshojë vetëm leje

pune afatshkurtra për të huajt, deri në 90 ditë brenda çdo periudhe prej 180 ditëve brenda 1 viti. Kosova nuk ka

ndonjë ligj të veçantë për këtë çështje sa i përket ardhjes së punëtorëve nga jashtë”, tha Sami Istrefi, njohës i çështjeve juridike.

Por si shkojnë procedurat për rekrutimin e këtyre punëtorëve tregoi Zana Beqiri, drejtoreshë ekzekutive e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë. “Migrimi afatshkurter është i mundshëm. Është i mundshëm edhe natyralizimi, pastaj bashkimi familjar dhe është i mundshëm edhe migrimi për çështje ekonomike dhe biznese. Por, në të shumtën e rasteve, po shohim se bizneset po i pajisin punëtorët nga jashtë me vizë afatgjatë për biznes dhe me leje qëndrimi, e cila ua garanton edhe lejen e punës”, tha ajo.

Bizneset disa herë kanë ngritur shqetësime se po u rrezikohet funksionimi në mungesë të stafit. Ato druajnë se pas janarit do të kenë krizë për punëtorë, andaj punësimi i të huajve shihet si zgjidhje.

Borxhi publik shënon rritje

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Për mbi 22 milionë euro është rritur borxhi ndërkombëtar i Kosovës gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti krahasuar me vitin e kaluar. Nga janari deri në qershor të 2023-s, borxhi i jashtëm kap vlerën e mbi 663 milionë eurove. Ndërsa borxhi i brendshëm, nga 1 miliard e 112 milionë euro sa ishte më 2022, në gjashtë muajt e parë të këtij viti ishte 1 miliard e 9 milionë euro.

Sipas Ministrisë së Financave, tërheqjet në shumat më të larta janë realizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Asociacioni

Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Por, si janë shfrytëzuar këto para ka treguar Përparim Kryeziu, zëdhënës i qeverisë. “Mjetet nga borxhi janë duke u shfrytëzuar për projekte të ndryshme infrastrukturore, për projekte të efikasitetit dhe energjisë dhe projekte për mbështetje në reforma strukturore për vendin. Të gjitha projektet janë në lidhje me programin qeverisës dhe prioritetet e ministrive përkatëse, qëllimi përfundimtar i të cilave është zhvillimi ekonomik i vendit dhe ngritja

e mirëqenies së qytetarëve”, ka thënë Kryeziu për “RTK”-në.

Sipas auditorit, qeveria duhet të sigurojë që para se të merren vendimet për financimin e projekteve me huamarje, të jenë bërë analiza të hollësishme me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të këtyre fondeve. Ndërkohë profesori i ekonomisë, Muhamet Sadiku, ka treguar se sa ka ndikuar në zhvillimin ekonomik rritja e borxheve. “Dy vjet për të bërë transformime, për të bërë kthesa në zhvillim, është një periudhë shumë e vogël, prandaj të



gjitha zhvillimet që kanë ndodhur janë rezultat i ndikimit të përhershëm. Por në dy vitet e fundit kanë munguar investimet publike të cilat janë në nivel tejet të

ulët dhe ato janë faktorë tejet të rëndësishëm të krijimit të bruto-produktit të vendit”, ka thënë profesor Sadiku. Borxhi publik i Kosovës ndër vite ka shënuar rritje.

Në origjinë të luftës civile kolumbiane (dhe akuzat për CIA-n)



Gjithçka filloi me vrasjen e një politikani karizmatik që ëndërronte të bëhej president i kombit të tij dhe ta bënte atë një fuqi të madhe. Ai ishte favoriti në zgjedhjet e ardhshme, vizioni i tij politik kishte magjepsur njerëzit dhe kokëfortësia e bënte atë një kërcënim për status quo-në. Nëse zgjidhej, ai mund të kishte ndikuar në trajektoren e historisë së Amerikës Latine. Nëse zgjidhej, Revolucioni Kuban do të kishte ndodhur në Bogota në 1950, në vend të Havanës në 1959. Politikani në fjalë quhej Jorge Eliécer Gaitán, ai ishte lideri i Partisë Liberale dhe nuk do të kishte mbërrinte i gjallë në zgjedhjet presidenciale të Kolumbisë të vitit 1950: ai u qëllua për vdekje më 9 prill 1948 në atë që ka mbetur, për të gjithë, një çështje e pazgjidhur. E cila vazhdon të përndjekë Kolumbinë, e cila ka qenë në luftë civile që nga ai 1948 i mallkuar.

Nga barrio në Plaza Bolívar

Jorge Eliécer Gaitán Ayala lindi në një ditë të papërcaktuar në janar 1903 në një nga lagjet më të varfra dhe më të rrezikshme të Bogotasë: barrio Egipto. Ai u rrit me nënën, me profesion mësuese, duke mësuar që në moshë të vogël të dashurojë librat dhe të lundrojë në ujërat e vështirësive.

Zhvilloi një karakter të çuditshëm në vitet e kolegjit, ndoshta si reagim ndaj ngacmimeve të

shokëve të klasës për shkak të pamjes së tij të zbehtë – një reflektim i kequshqyerjes -, duke iu afruar ideve të socializmit liberal kolumbian, pas hyrjes në universitet.

I shkëlqyer, por plot energji, në kufi me problematiken, Gaitán shpejt do të bëhej studenti më i njohur i Universitetit Kombëtar të Kolumbisë, ku themeloi një rreth letrar dhe një qendër liberale. Pas diplomimit për drejtësi dhe shkenca politike në 1924, Gaitán mori një bursë për të vazhduar studimet në Romë. Ai u kthye në Bogota në vitin 1928, me një doktoraturë dhe aftësi oratorike të mësuar duke dëgjuar fjalimet e Benito Musolinit, i vendosur për të hyrë në politikë.

Paraqitja e tij e parë në Kongres, si avokat, ishte një sukses i madh: fjalimi i Gaitán-it, i cili ishte thirrur të fliste për masakrën e bananeve – një masakër me autore United Fruit Company – do t'i jepte pseudonimin "Tribuna e popullit" nga shtypi si dhe rekrutimin në Partinë Liberale. Rruga e Gaitán-it dukej e destinuar për presidencën. Në vitin 1931 zgjedhja si Kryetar i Dhomës së Përfaqësuesve. Në vitin 1933 ai u emërua negociator i qeverisë në krizën midis Kolumbisë dhe Perusë. Në vitin 1936 ndodhi transformimi në kryetar bashkie të Bogotas. Në vitin 1940 titullar i ministrisë së arsimit. Në vitin 1946 gara e parë drejt Casa de Nariño përfundoi në vendin e tretë.

Dy vjet më vonë, në gjysmë të rrugës së zgjedhjeve të reja

presidenciale, Kolumbia kishte filluar të ndjente efektet e fillimit të Luftës së Ftohtë: barbarizmin e diskursit politik, polarizimin e shoqërisë në ekstremizma, radikalizimin në forcat e armatosura, teksa trazirat dhe politikën e dhunës ishin dukuri e përhapur dhe e përditshme. Përpjekjet e Gaitán-it për të korrigjuar situatën duke rregulluar superstrukturën do të rezultojnë fatale.

Nga Bogotazo në Dhunë

Kolumbi, 1948. Liberalët dhe konservatorët janë në gjendje luftime: pritë, përleshjet dhe vrasjet ndodhin çdo javë. Një lloj histerie kolektive ka kapluar klasën sunduese, e cila akuzon liberalët se janë të paguar nga Bashkimi Sovjetik, dhe thirret e Gaitánit për qetësi janë ulërima në shkretëtirë. Kanë mbetur edhe dy vjet para zgjedhjeve të ardhshme presidenciale, të planifikuara për në vitin 1950, dhe Gaitán ka bërë fushatë që nga viti 1946. Ai premton të transpozojë politikën e deoligarkizimit të bujqësisë dhe masat kundër analfabetizimit që e bënë atë të famshëm në Bogota në nivel kombëtar. Ka bërë miqësi me presidentin e majtë të Venezuelës Rómulo Betancourt dhe po ndjek nga afër situatën në Kubë.

Më 9 prill, ditën e vrasjes së tij, Gaitán kishte në plan të takonte një të ri që kishte ardhur nga Havana për ta njohur, njëfarë Fidel Kastro. Por të dy nuk u takuan kurrë: tribuna e njerëzve

u qëllua për vdekje nga një i panjohur rrugës për në Hotel Continental. Turma e kapi autorin e dyshuar të pritës një punëtor ndërtimi, Juan Roa Sierra, dhe e linçoi për vdekje. Gaitán vdiq në spital disa orë pas atentatit. Njoftimi i largimit të tij nga kjo botë erdhi si një tronditje për popullsinë e kryeqytetit, e cila atë ditë shkaktoi një kryengritje të furishme, e njohur në histori si Bogotazo, e cila kulmoi me mbi 600 vdekje, 450 plagosje dhe mbi 500 arrestime. Fillimi i luftës civile para luftës civile: dhuna (la violencia).

Nga dhuna te lufta civile

Historiografia e tregon me gisht vrasjen e liderit komunist Jacobo Prías Álape, më 11 shkurt 1960 nga një komando bandoleri, si casus belli-n e luftës civile kolumbiane. Por e vërteta është se në vitin 1960, vendi kishte qenë tashmë në luftë prej dymbëdhjetë vjetësh. Vrasja brutale e Gaitán-it inkurajoi liberalët dhe komunistët të formonin komitete vetëmbrojtjeje, të cilat shpejt u zhvilluan në lëvizje guerile, duke ndezur një rreth vicioz të hakmarrjes, i cili deri në vitin 1960 do të linte të vdekur, dyqind mijë civilë, pesëmbëdhjetë mijë guerrillas/paraushtarakë të majtë, pesë mijë guerrilë/paraushtarakë të djathtë dhe gati pesë mijë pjesëtarë të forcave të rendit dhe të forcave të armatosura.

Bota besonte se gadishulli Korean ishte teatri kryesor i

konfrontimit hegjemonik midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik. Në fakt, ishte në Kolumbi që të dy superfuqitë kishin filluar të luftonin, në vitin 1948, duke financuar armatimin dhe radikalizimin e konservatorëve dhe liberalëve.

Nga dokumentet e deklasifikuara në vitet që pasuan, të cilat përbëjnë një pjesë pafundësisht të vogël të dosjes së Kolumbisë – e cila mbetet në thelb e klasifikuar -, doli se CIA ishte kaq e shqetësuar për figurën dhe idetë e Gaitán-it, pasi konsiderohej i aftë të projektonte Kolumbinë në orbitën e Bashkimit Sovjetik, sa që kishte një dosje për të.

Sipas një versioni të një agjenti të Langley, John Mepples Spirito, hetimi ndaj Gaitán-it ka qenë përgatitor për planifikimin e vrasjes së tij. Por ideja e atentatit nga CIA u dobësua më pas nga tërheqja e vetë Mepples dhe asnjë provë tjetër në këtë drejtim nuk ka dalë që atëherë. Gjithashtu sepse çdo dokument që disponojnë Shtetet e Bashkuara për çështjen Gaitán mban mbishkrimin "sekret shtetëror".

Vrasja e Gaitán-it, dekada më vonë, mbetet një nga misteret e mëdha të Amerikës Latine. Një episod që ndihmoi në ndryshimin e rrjedhës së Luftës së Ftohtë në kontinentin jugor, i cili shkaktoi luftën më të gjatë civile të kohës sonë dhe ndaloi (përgjithmonë?) garën e Kolumbisë drejt madhësisë. / Il Giornale – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT



Gliha: Për Kosovën jemi gati të vdesim në fushë

“Dardanët” janë në prag të ndeshjeve kualifikuese për Kampionatin Evropian. Ata do të përballen me Zvicrën dhe Rumaninë. Përzgjedhësi Primoz Gliha tha se futbollistët duhet të jenë gati që të vdesin në fushë kur luajnë për ekipin kombëtar. “Ne duhet të jemi gati edhe të vdesim në fushë, pasi luajmë për ekipin kombëtar, dhe për një futbollist profesionist nuk ka gjë më të rëndësishme. Nuk luajmë për para, por për dinjitet dhe duhet ta tregojmë në fushë këtë”, ka thënë Gliha

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll është grumbulluar për ndeshjet e shtatorit ku do të përballen me Zvicrën më 9 shtator në stadiumin “Fadil Vokrri” dhe tri ditë më vonë me Rumaninë në udhëtim. Përzgjedhësi i “dardanëve”,

Primoz Gliha, në konferencën për medie ka thënë se të gjithë në përfaqësuese duhet të jenë gati dhe të vdesin në fushë për të marrë më të mirën. “Ne duhet të jemi gati edhe të vdesim në fushë, pasi luajmë për ekipin kombëtar, dhe për një futbollist profesionist nuk ka gjë më të rëndësishme. Nuk luajmë për para, por për dinjitet dhe duhet ta tregojmë



në fushë këtë”, ka thënë Gliha, i cili ka folur më pas edhe për lojtarët e rinj të ftuar në përfaqësuese si dhe për mesfushorin e Ballkanit, Lindon Emërllahu. Gliha ka bërë me dije se e ka pasur në plan ta ftojë Emërllahun, por një gjë e tillë

ishite pamundur për shkak të lëndimit. “Besoj se e keni parë listën dhe aty ka disa emra futbollistësh të rinj. Janë disa futbollistë që kanë qenë pjesë e Kosovës U21 dhe po përipiqemi të bashkëpunojmë për t'i vënë sa më shpejt në dispozicion të skuadrës së parë. Tani do të

punojmë për t'i parë rezultatet në fushën e lojës. Rezultati është primar dhe në funksion të arritjes së tij do t'i zgjedhim edhe futbollistët e skemën. Tani asgjë nuk është e lehtë, pasi kishim në plan grumbullimin e Emërllahut, por ai u lëndua”, ka shtuar ai.

Numri një i “dardanëve” e ka komentuar edhe zgjedhjen e Arbnor Mujës për ta përfaqësuar Shqipërinë: “Muja është një shembull, shembull që do të mësojmë në të ardhmen. Mirëpo ai e kishte marrë vendimin, nuk kishim çfarë të bëjmë më. Do të tentojmë që lojtarët më të mirë t'i mbajmë në Kosovë”.

Në grupin e Kosovës, Zvicra prin me 10 pikë, ndjekur nga Rumania me 8 sosh. Izraeli është i treti me 7 pikë. Andorra është e fundit me vetëm 1 pikë.

Kelmendi: Si trajnere po i shijoj më shumë sukseset e xhudos

PEJË, 4 SHTATOR - Majlinda Kelmendi ka filluar të japë rezultate impresionuese tashmë edhe si trajnere e xhudos. Nën drejtimin e saj dhe të Driton Kukës, xhudistët kosovarë fituar tetë medalje të arta individuale si dhe u shpallën kampionë ballkanikë në garën ekipore. Kelmendi ka thënë për “KosovaPress” se sukseset ishin të pritshme, por që u befaskan nga disa prej xhudistëve të rinj. “Realisht për ditën e djeshme, në gara individuale, ka shkuar më mirë sesa e kemi pritur. Sigurisht që prej Lorianës, Akilit, Distrisë kemi pritur medalje të arta, mirëpo Muhamedin Veseli edhe Dion Sharapolli na kanë befasuar për të mirë. Kjo tregon që në xhudos e Kosovës do të dalin në të ardhmen edhe emra të rinj. Në përgjithësi ka shkuar jashtëzakonisht mirë. Jemi kënaqur. Garat ekipore në përgjithësi janë me adrenalinë, shumë interesante, kështu që ka qenë atmosferë jashtëzakonisht e mirë. Garuesit kanë qenë jashtëzakonisht të motivuar”, ka thënë Kelmendi. Ajo shtoi se garuesit u



motivuan shumë nga fakti se kjo garë u zhvillua në Kosovë, posaçërisht në qytetin e Pejës. “Sigurisht që po, nëse Kampionati Ballkanik do të ishte mbajtur në ndonjë shtet tjetër jam e sigurt që asnjëri prej garuesve nuk do të kishte shprehur vullnet të marrë pjesë, por përderisa është mbajtur në Kosovë, në qytetin tonë, në qytetin e Pejës, secili ka qenë i gatshëm të marrë pjesë për faktin që ndoshta janë familjarët këtu, janë bashkëqytetarët, kështu që me

kënaqësi kanë marrë pjesë”, ka theksuar Kelmendi.

Më tutje, Majlinda Kelmendi ka bërë me dije se tani do të përgatiten për Kampionatin Evropian të Xhudos që zhvillohet po në Kosovë në muajin dhjetor dhe se aty synojnë suksese të tjera. “Po besoj që po, jemi duke punuar intensivisht, jemi duke u përgatitur në maksimum. Edhe Kampionati Evropian do të jetë jashtëzakonisht i fortë. Presim shumë më shumë njerëz të vijnë që ta shohin garën. Do të jetë shumë interesante. Do të marrin pjesë yjet botërore, kështu që po besojmë se do të kemi sukses”, ka shtuar ish-kampionia olimpikë.

Ajo thekson se për dallim nga koha kur garonte dhe e kishte presionin e fitimit të medaljeve, tani si trajnere po e shijon shumë më shumë këtë sport. “Sigurisht që po, po e shijoj në maksimum. Si garuese kam pasur shumë stres, shumë ngarkesë dhe presion, ndoshta për vetë faktin që të gjithë shqiptarët prisnin që Majlinda të jetë e para, kështu që tani si trajnere po e shijoj shumë më shumë”, ka deklaruar Kelmendi.

Kenan Haxhihamza, ‘Ylli i javës’ në Superligë

Klinë, 4 shtator - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Në xhiron e katërt të Albi Mall Superligës ky çmim i ka takuar portierit të KF Dukagjini, Kenan Haxhihamza. Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Naser Bunjaku, Luan Tabaku dhe Vllaznim Visoka vendosi që epiteti i më të mirit për këtë xhiro t'i takojë portierit të skuadrës nga Klina, pasi në ndeshjen kundër FC Drita pati paraqitje të mirë, teksa në minutat e fundit e mbrojti penalltinë, që i mundësoi skuadrës së tij ta fitojë një pikë, duke e mbyllur ndeshjen baras

2-2. Çmimin “Ylli i javës” për futbollistin e KF Dukagjini, Kenan Haxhihamza, e dha Erijon Meha, menaxher i kreativës në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim, Haxhihamza u shpreh i lumtur që skuadra e tij arkëtoi një pikë si mysafir ndaj njërit prej kundërshtarëve më të fortë. “Ky çmim i takon ekipit tim që në ndeshjen e javës së 4-t kemi bërë një lojë shumë të mirë. Gëzohem që në fund të ndeshjes e dhashë kontributin tim për të fituar një pikë shumë të rëndësishme e që shpresoj të jetë një pikë kthese për skuadrën tonë”, ka thënë Haxhihamza për faqen zyrtare të FFK-së.



Drenica shkarkon trajnerin Sunaj Keçi

SKENDERAJ, 4 SHTATOR - FC Drenica e ka shkarkuar nga pozita e trajnerit Sunaj Keçin. Klubi kuqezi ka njoftuar se për këtë vendim janë rezultatet e dobëta në tri ndeshjet e para kampionale. Drenica ka marrë 1

pikë në tri ndeshjet e para. “Pas rezultateve të dobëta në tri ndeshjet e Ligës së Parë të Kosovës në Futboll, bordi i klubit ka mbajtur mbledhje urgjente dhe ka vendosur unanimisht për ndërprerjen e

bashkëpunimit me trajnerin Sunaj Keçi. E falënderojmë trajnerin Keçi për bashkëpunimin e deritanishëm dhe i dëshirojmë suksese në vazhdim të karrierës së tij. Ambiciet e klubit janë serioze

dhe të mëdha dhe, si rrjedhojë e kësaj, ka ardhur edhe deri te ky vendim. Klubi do të angazhohet me gjithë potencialin dhe mundësitë që ka për t'i bërë zgjedhjet e duhura për t'iu kthyer rezultateve pozitive. Ne



nuk dorëzohemi”, thuhet në njoftimin e Drenicës.

Rashica: Jam i lumtur që shënova gol, morëm tri pikë të rëndësishme

STAMBOLL, 4 SHTATOR -

Reprezentuesi "dardan", Milot Rashica, është shprehur i lumtur për fitoren e arritur me skuadrën e Beshiktashit ndaj Sivassporit (2-0), por edhe me golin e parë të shënuar me

fanellën e kësaj skuadre.

Vushtriasi luajti për 63 minuta, teksa ishte autor i golit të dytë në këtë ndeshje. "Jam shumë i lumtur që jam në Beshiktash. Jam i lumtur që shënova gol. Ishte e

rëndësishme t'i marrim tri pikë para tifozëve. Do të kthehem edhe më të fortë pas pushimit ndërkombëtar. Ne po përmirësohemi çdo ditë. Përshtatja e lojtarëve të rinj po bëhet më e mirë me praktikën.

Jemi vetëm në fillim. Do të bëjmë shumë më mirë", ka thënë Rashica. "Familja ime më shikonte nga tribuna. Gjithashtu ishte shumë e rëndësishme ta festoja golin me të", ka shtuar Rashica.



Bajrami e Cikalleshi premtojmë maksimumin ndaj Çekisë dhe Polonisë

TIRANË, 4 GUSHT - Kombëtarja e Shqipërisë i zhvillon dy ndeshje të rëndësishme. Ajo do të udhëtojë në Çeki, më pas do ta presë në shtëpi Poloninë. Këto ndeshje vlejnjë për kualifikimet e Kampionatit Evropian "Gjermani 2024". Këto ndeshje zhvillohen më 7 dhe 10 qershor. Para medieve në ditën e parë të tubimit ka folur mesfushori Nedim Bajrami i cili u shpreh i bindur se Shqipëria mund të luajë mirë në këto dy ndeshje. "Kemi ndeshje të vështirë me kundërshtar të fortë por përgatimis ndeshjen mirë. Jemi gati dhe japim maksimumin për këtë ndeshje. Kam folur me trajnerin dhe më ka ndihmuar. Jam i lumtur që ka ardhur Silvinjo këtu. Duhet të fitojmë dhe nëse nuk ia dalim, të mos humbasim", ka thënë futbollisti nga Maqedonia e Veriut, i cili aktivizohet për Empolin. Krahas tij, në konferencë është paraqitur edhe sulmuesi Sokol Cikalleshi, i cili e ka nisur me 2 gola në katër ndeshjet e para me Konyasporin në Turqi. "Mendoj se ky grumbullim është ndër më të rëndësishmit në këto vite. Janë dy ndeshje që duhet fokus dhe angazhim. Për mua është kënaqësi e dyfishtë sepse kam përjetuar një Evropian nëse do të shkoj sërish, ka



tjetër kuptim. Të gjithë lojtarët që e kanë arritur në 2016, duhet të bëjnë më shumë jashtë fushe për të pasur angazhim maksimal", ka thënë Cikalleshi. "Këto dy ndeshje janë deçizive dhe normal duam të marrim 3 pikë dhe të kthehem të gëzuar. Çekia është shumë e mirë dhe ka eksperiencë në Evropë. Angazhimi dhe fokusi duhet të jetë maksimal. Në grumbullimin që shkoi, bëmë detyrat e shtëpisë dhe nuk duhet të kënaqemi. Këtë javë dalin burrat në shesh. Kemi nevojë për mbështetjen e medias dhe tifozëve sepse duke qenë bashkë, ia arrijmë kësaj ëndre. Është një ekip që do të vuajmë por jemi gati sepse kemi shënuar, kemi luajtur dhe mbrojtësit kanë minuta. Jemi në

moment shumë të mirë por ndeshja do të kalojë dhe më shumë mundësi i jap angazhimit dhe ju siguroj se do të jetë. Ne nuk jemi Kombëtare që arrijmë në Botëror ose Evropian çdo dy vite por tani kemi mundësi të realizojmë ëndrën. Kemi arritur vetëm 1 herë dhe kemi mundësi për të arritur për herë të dytë. Këto dy ndeshje janë më të rëndësishmet dhe unë nuk dua të flas për ëndrën për t'u kualifikuar sepse mund të hapë punë edhe ndeshja me Ishujt Faroe por duke pasur një objektiv të qartë, duhet të mendojmë vetëm Çekinë dhe për të marrë 3 pikët. Nëse nuk i arrijmë, duhet të mos dalim të humbur", ka shtuar Cikalleshi.

SHKURT

Xavi: Joao Felix është i rëndësishëm për ne

Barcelona shënoi të dielën fitore ndaj Osasunës me rezultat 2-1. Në këtë ndeshje debutoi transferimi i ri Joao Felix. Trajneri Xavi Hernandez ka thënë se portugezi është një lojtar i rëndësishëm për skuadrën e tij. "Joao Felix e shoh si '9' dhe në krahun e majtë. Më pëlqeu paraqitja e Joaos që në ndeshjen e parë me ne. Të gjithë ata që hynë nga stoli ndihmuan për këtë fitore. Dua të theksoj se qëndrimi i tij është shumë i rëndësishëm për skuadrën", ka deklaruar Xavi.

Ramosi rikthehet te Sevilla

Mbrojtësi legjendar i Spanjës dhe Real Madridit, Sergio Ramos, do të rikthehet te Sevilla, shkruan gazetari Fabrizioo Romano. Marrëveshja verbale në mes të mbrojtësit dhe klubit është arritur, duke ua mbyllur kështu derën ofertave nga Arabia Saudite dhe Turqia. Spanjolli do të kthehet te klubi nga Andaluzia pas 18 vjetëve, pasi në vitin 2005 ishte transferuar në Real Madrid.

Inzaghi: Është vetëm fillimi, Lautaro lider i këtij ekipi

Skuadra e Interit regjistroi fitore fantastike ndaj Fiorentinës me rezultat 4-0 në "San Siro". Trajneri Simone Inzaghi ka mbetur shumë i kënaqur nga skuadra e tij nga paraqitja dhe ndeshja e zhvilluar dhe ka deklaruar se Lautaro Martinez është lideri i madh i tyre. "Kemi pasur tri ndeshje të shkëlqyera, djemtë punojnë mirë dhe me shpirt, për klubin dhe për tifozët. Këto janë shenja të shkëlqyera, por është vetëm fillimi. Doja që Thuram ta gjente golin dhe ia doli. Jam i lumtur dhe ai bëri shumë mirë si të gjithë ata që luajtën. Jam shumë i kënaqur. Duhet theksuar se Lautaro është një lider i madh", ka thënë Inzaghi.

Djokoviçi shkon në çerekfinale, eliminohet numri 1 në botë për femra

Ndeshjet e raundit të katërt të US Open në tenis kanë dhuruar surpriza, siç është eliminimi i numrit 1 në botë për femra, Iga Swiatek. Tenistja polake u mund 2-1 (3-6, 6-3, 6-1) nga letonezja Jelena Ostapenko. Fitore me përmbysje e kësaj të fundit, që avancojnë në çerekfinale. Më tej avancojnë edhe tenistja amerikane Coco Gauff (numri 6), që mundi 2-1 danezen Caroline Wozniacki (6-2, 3-6, 6-1). Nuk zhgënjën as numri 10 në botë, tenistja çeke Karolina Muchova, që mundi 2-1 kinezën X. Wang. E fundit që avancojnë në raundin tjetër është tenistja rumune Sorana Cirstea, që mundi 2-0 Belinda Bençiq. Te meshkujt, serbi Novak Djokoviçi fitoi me lehtësi 3-0 (6-2, 7-5, 6-4) ndaj kroatit B. Gojo. Në çerekfinale kualifikohen edhe tre tenistë amerikanë, që po paraqiten mirë në turneun e shtëpisë. Bëhet fjalë për Ben Shelton (3-1 ndaj T. Paul), Francis Tiafoe (3-0 ndaj R. Hijikata) dhe Taylor Fritz (3-0 ndaj D. Stricker).

Shiten të gjitha biletat e ndeshjes Shqipëri - Poloni

TIRANË, 4 SHTATOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll do të luajë këtë muaj dy ndeshjet e radhës në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian "Euro 2024". Shqipëria do të luajë në udhëtim ndaj Çekisë më 7 shtator, kurse pas tri ditësh e pret Poloninë.

Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF) ka bërë me dije se për ndeshjen ndaj polakëve janë shitur të gjitha biletat. Kështu, "kuqezinjve" nuk do t'u mungojë as kësaj radhe përkrahja e madhe nga tribunat në stadiumin "Air Albania". "Të gjitha biletat e vlefshme për



ndeshjen Shqipëri - Poloni, e vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Evropian 'Gjermani 2024' janë shitur. Federata Shqiptare e Futbollit dëshiron të falënderojë të gjithë tifozët shqiptarë që kanë vendosur të

jenë të pranishëm në stadiumin 'Air Albania' më 10 shtator, në mbështetje të ekipit tonë kombëtar dhe i fton të krijojnë një atmosferë të ngrohtë, pozitive dhe të tregojnë respekt ndaj ekipit kundërshtar. Njëkohësisht, Federata e Futbollit i bën thirrje edhe tifozëve kuqezinj, të cilët nuk kanë mundur të pajisen me bileta për këtë ndeshje kaq të rëndësishme për të gjithë, të vazhdojnë ta përkrahin Kombëtaren e zemrës së tyre. Të mbështesim kuqezinjët tanë të gjithë se bashku! ME JU, NE JEMI 12!", thuhet në njoftimin e FShF-së.

Arteta: Ky ekip nuk dorëzohet kurrë, pas 38 javësh do të jemi ku e meritojmë

Trajneri Mikel Arteta është shprehur i kënaqur me karakterin e skuadrës së tij gjatë ndeshjes ndaj Manchester Unitedit (3-1). Strategu spanjoll ka deklaruar se pas javës së 38

javësh, Arsenali do të jetë aty ku e meriton. "Sigurisht që jam shumë i lumtur. Unitedi është një skuadër e shkëlqyer, e menaxhuar shumë mirë dhe ata ta bëjnë jetën të vështirë. Kur

dhuruam golin e parë, ai kthehet gjithnjë në një bumerang dhe në Premierë Ligë është shumë i rrezikshëm. Por ia dolëm në fund falë karakterit dhe dëshirës së kësaj skuadre për të mos u

dorëzuar", ka thënë Arteta. "Ishte diçka e bukur mënyra sesi ne e kthyem ndeshjen dhe e fituam atë. Kur unë shoh një skuadër me këtë dëshirë për të fituar dhe etjen për të provuar përsëri, është

diçka shumë e bukur. Jam shumë krenar për këta lojtarë. Kjo është e bukura e futbollit. Janë luajtur vetëm 34 javë. Pas 38 javësh ne do të jemi atje ku e meritojmë", ka deklaruar Arteta.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:113130
Datë: 31.08.2023
Numri i dokumentit: 04636108

C.nr.383/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, kryetar i kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Fitim Hazir Gashi nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Sefer Morina nga Prizreni, kundër të paditurës Maria (Ioan) Roşu me vendbanim në Saravale, Timis, Romani, për shkak të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim, me datë 31.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurës Maria (Ioan) Roşu me vendbanim në Saravale, Timis, Romani, tani me adresë të panjohur, I CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm avokati Arif Morina nga Rahoveci.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi Fitim Hazir Gashi nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, kësaj gjykate i ka ushtruar padinë kundër të paditurës Maria (Ioan) Roşu me vendbanim në Saravale, Timis, Romani, për shkak të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim.

